Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

331/20
29.06.2020

PSH .nr.331/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULANT SHPK"- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit" me nr. të prok: "KEKO-20-093-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a, më datën: 26.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET , pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULANT SHPK"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit" me nr. të prok: "KEKO-20-0932-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a.

II.ANULOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit" me nr. të prok: "KEKO-20-0932-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a. dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULANT SHPK"- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULANT SHPK"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 27.05.2020 me nr.331/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Përgatitja e dokumentacionit për mbrojtjen kundër zjarrit" me nr. të prok: "KEKO-20-0932-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 51, 56, 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe Rregullat e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.06.2020, ka autorizuar eksperten profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Pretendimi i parë i OE ankues është se prentendimi ankimorë i AK -se se nuk keni dorëzuar referenca të natyrës së ngjashme, janë kërkuar tri (3) projekte elaborate të ngjashme të hartuara për mbrojtje kundër zjarrit për objekte industrial të lëshuar nga pranuesi I shërbimit. Ne kemi ofruar 4 kontrata të bashkangjitura me referenca konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1 & 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë të ngarkuara në e -prokurim gjatë dorëzim të ofertës .

1. Hartimin e eleboratit për mbrojtje kundër zjarrit për nevojat e kompletimin e pëlqimive dhe dokumentacioneve për fabrikën e përpunimit të qumështit " sharri " në Prizren.
2. Hartimin e elboratit për mbrojtje kundër zjarrit për industrin (fabrikën) e prodhimit të betonit „ Erurovia shpk " - Prizren :
3. Hartimin dhe kompletimin e dokumentacionit dhe elaboratin për mbrojtje ndaj zjarrit dhe shpëtim për rezervuaret e perpunimit të naftës në zonen industriale Porto-Romano në Durrës.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë konstaton se kërkes e AK-

së ne DT ka qenë:

1.Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit.	**1.Një liste te shërbimeve të ngjashme të OE qe specifikon shërbimet e kryera, shumën kontraktuare, datën dhe pranuesin. Te prezantohen minimum tri (3) projekte elaborate të ngjashme të hartuara për mbrojtje kundër zjarrit për objekte industriale te lëshuara nga pranuesi i shërbimit në tri vitet e shkuara nga publikimi i njoftimit për kontrate për kryerjen e shërbimit.**

Bazuar ne kërkesen e AK-së dhe dokumentacionit ne oferten e OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se OE në fjalë në oferten e tij ka të bashkangjitur listen e kontratave dhe referencat për punët e kryera me sukses si me poshshtë: Me tej eksperti shqyrtues sqaronse Industria është një degë e veprimtarisë ekonomike që synon prodhimin e një produkti ose nxjerrjen e burimeve, andaj kontrata me titull:"Hartimin elaboratit për mbrojtjen kundër zjarrit për fabrikën prodhuese qumështit në zonën Industriale" " Sharri " në Prizren është pjesë e industris, dhe si e tillëkjo fabrikë e perpunimit të qumshtit bënë pjes ne objektet e industris ushqimore.

Gjithashtu sa i perket pikes ankimore nr.2 per sherbimet e kryera per kontratën me titull:Hartimin e laboratit për mbrojtjen kundër zjarrit për fabrikën prodhuese të Betonit në Prizren. Ekspertishqyrtues duke u bazuar ne degete industrisësqaron se, industritë quhen pjesë individuale të sektorit të prodhimit, ndërmarrjet e të cilave synojnë prodhimin e produkteve specifike ku çdo industri ka teknologjinë dhe veçoritë e veta, dhe si rrjedhoj e kësaj del se Fabrika prodhuese e betonit në fjalë bënë pjesë ne industrin e ndertimit. Dhe si i till ky pretendim akimor qendron.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë konstaton se OE ankues ka të bashkangjitur ne oferte listen e kontratave dhe referencat per perfundimin me sukses te punëve mirpo bazuar ne dy referencat e dorëzuara nga ana e OE ankues ku njer ka të bëjë me Hartimi i projektit për zgjerimin e kapacitetve në industrinë e naftës dhe hidrokarburëve: Pike Furnizimi me Karburant Farke & Njesi Sherbimi" Farke e Madhe. 1. Kompletimi e dokumentacionit dhe elaboratin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MNZ): Kapaciteti I rezervuareve 95000 L (llogaritja e volumit te dobishem eshte 4-6% me e vogel se madhesia gjeometrike)dhe tjetra me 2. Kompletimi e dokumentacionit dhe elaboratin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MNZ): Kapaciteti i rezervuareve me kapacitet gjeometrik 12 000m3 secili dhe nje rezervuar me kapacitet gjeometrik 16 000 m3 ,dy rezervuare me kapacitet gjeometrik 25 000 m3 secili, nje me kapacitet2 000m3 dhe nje me kapacitet 100 m3. Me tej eksperti shqyrtues duke u bazuar ne deget e industris ku dihet se Industria është degë

ekonomike,e cila merret me përpunimin dhe transformimin e lëndës së parë me prejardhje organike,inorganike dhe minerale në gjysëmfabrikate dhe prodhime finale qe i kushtohen konsumit të gjerë ose prodhimit të mëtutjeshëm, sqaron se të dy referencat e dorëzuara nga ana e OE ankues nuk kane të bëjne me objekte industriale por kan të bëjne me Kompletimi e dokumentacionit dhe elaboratin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MNZ) për rezervuaret te naftes. Sa i perket Aneksit 1 ligjit Nr.9298 , date 28.10.2004 kjo ka të bëjë me nje projekt qe Qeveria e Shqiperis ka ratifikuar një marrveshje me titull. PER RATIFIKIMIN E "MARREVESHJES SE KONCESIONIT, TE FORMES "BOT" (NDERTIM, SHFRYTEZIM, TRANSFERIM), PER NDERTIMIN DHESHFRYTEZIMIN E PONTILIT TE NAFTES, GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TETYRE NE ZONEN BREGDETARE TE PORTO-ROMANOS, DURRES". Kjo marrveshje nuk ka të bëje me referencat në fjalë. Prandaj bazuar ne kërkesat e AK dhe sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor nuk qendron pasiqe rezervuaret e naftes nuk kan ndonje proces prodhimi por sherbejn vetem per deponi të derivateve edhe pse kan rrezikshmerin e madhe nuk mund të llogariten si objekte industriale.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për Anulim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 16.06.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo të njejtit nuk kanë kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik, me datë: 22.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 26.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,
njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të
prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë,

diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit per anulim te aktivitetit te prokurimit ne fjale.

Lidhur me arsyen e eliminimit te operatorit ekonomik ankues te dhënë nga ana e AK-se , se ju si OE nuk keni dorëzuar referenca të natyrës së ngjashme, ku janë kërkuar tri (3) projekte elaborate të ngjashme të hartuara për mbrojtje kundër zjarrit për objekte industrial të lëshuar nga pranuesi I shërbimit.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues ka ofruar kontrata të bashkangjitura me referenca konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1 & 9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë të ngarkuara në e -prokurim gjatë dorëzimit të ofertës si me poshtë :

1. Hartimin e elaboratit për mbrojtje kundër zjarrit për nevojat e kompletimin e pëlqimeve dhe dokumentacioneve për fabrikën e përpunimit të qumështit " sharri " në Prizren.

2. Hartimin e elaboratit për mbrojtje kundër zjarrit për industrinë (fabrikën) e prodhimit të betonit „ Erurovia shpk " - Prizren :

3. Hartimin dhe kompletimin e dokumentacionit dhe elaboratin për mbrojtje ndaj zjarrit dhe shpëtim për rezervuarët e përpunimit të naftës në zonën industriale Porto-Romano në Durrës.

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë sqarojmë se kërkesë e AK-së ne DT ka qenë:

1.Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit.	1.Një liste te shërbimeve të ngjashme **të OE qe specifikon shërbimet e kryera, shumën kontraktuare, datën dhe pranuesin. Te prezantohen minimum tri (3) projekte elaborate të ngjashme të hartuara për mbrojtje kundër zjarrit për objekte industriale te lëshuara nga pranuesi i shërbimit në tri vitet e shkuara nga publikimi i njoftimit për kontrate për kryerjen e shërbimit.**

Andaj duke u bazuar ne kërkesën e AK-se te cekur si me lart paneli konstaton se OE ankues ka ofruar dëshmi te mjaftueshme për shërbime te ngjashme dhe se nuk qëndron arsyeja e eliminimit te OE ankues e dhëna nga ana e autoritetit kontraktues për këtë pike.

Paneli shqyrtues konstaton se duke pas parasysh faktin se dëshmitë e ofruara nga ana e OE ankues per kërkesën e cekur si me lart kanë të bëjnë me Kompletimin e dokumentacionit dhe elaboratin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MNZ) për rezervuarët te naftës, konstatojmë se këto dëshmi janë te ngjashme me aktivitetin e

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ne mënyre që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta beje vetëm ne baze te kërkesave te dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate duke mos e eliminuar asnjë operator ekonomik edhe në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a

1x1 OE -"STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULANT SHPK"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.